



EKSTRAKT NGA
RAPORTI
VJETOR I TIA-s
2009

Tirana International Airport SHPK
Tirana International Airport
Nënë Tereza
Administration Building, Rinas
Tirana, Albania
Phone: +355 4 2381 600
Fax: +355 4 2381 545
E-Mail: info@tirana-airport.com

Një përmbledhje për 2009

11 mars 2009 - Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës mori pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit Berlin 2009. Arritjet e dukshme të TIA-s u paraqitën për të tretin vit radhazi në Berlin. TIA e mbështeti këtë event të medias ndërkombëtare si një instrument të vlefshëm për promovimin e potencialeve dhe tërheqjen e vëmendjes ndërkombëtare në drejtim të Shqipërisë, duke demonstruar angazhimin e vazhdueshëm të Aeroportit për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Shqipëri.

1 prill 2009 - Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës testoi me sukses gatishmërinë e kapaciteteve të tij duke simuluar një situatë emergjente. Në këtë ushtrim, u përfshinë struktura të tilla si: Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (Ministria e Brendshme), Departamenti i Zjarrfikëses, Njësia e Ndihmës së Shpejtë, Shërbimi Spitalor, Policia, Ushtria dhe rreth 100 vullnetarë. Të pranishëm në momentin e testimit ishin edhe zyrtarë nga Autoritetet e Aviacionit Civil, pushteti lokal, Misioni i Asistencës së Policisë të Bashkimit Evropian në Shqipëri (PAMECA), dhe përfaqësues nga Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE).

10 qershor 2009 -TIA zgjeron portofolin e avionëve me mbërritjen e një modeli të ri avioni "Airbus A310-300" për transport mallrash. Modeli i avionit "Airbus A310-300" transporton mallra midis Turqisë, Italisë dhe Shqipërisë.


14 qershor 2009 -Një itinerar i ri filloi të funksionojë midis kryeqytetit shqiptar dhe qytetit më të madh të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjatë verës linja ajrore "Skanderbeg Air" ofroi shërbimin e saj me një avion B767-200 nën drejtimin e kompanisë Sky King Inc.

20 gusht 2009 - TIA testoi me sukses terminalin e saj të zgjeruar. Të gjitha masat e sigurisë dhe procedurat e Aeroportit kaluan pa vështirësi dhe Faza B e zgjerimit të terminalit mori aprovimin e pasagjerëve përpara ceremonisë zyrtare të përfundimit që u zhvillua muajin e ardhshëm.

9 shtator 2009 - Përfundimi i zgjerimit të terminalit të ri shënoi përfundimin e Fazës B të zhvillimit dhe modernizimit të Aeroportit. Zgjerimi i terminalit u përfundua në një ceremoni gala ku morën pjesë rreth 300 të ftuar duke përfshirë Kryeministrin e vendit Prof. Dr. Sali Berisha, zyrtarë të lartë të shtetit, Dr. Peter Noé (Anëtar i Bordit të HOCHTIEF AG), Dr.Reinhard Kalenda, (Drejtor i Përgjithshëm i Bordit Drejtues për TIA-n) dhe përfaqësues të shoqërive aksionere, partnerë biznesi si dhe punonjësit e TIA-s.

Të dhëna mbi trafikun ajror

Statistikë	Trafiku Ajror		
	Viti 2009	Viti 2008	Δ %
Pasagjerë	1,394,688	1,267,041	10,1%
ATM-të	10,032	9,597	4.5%
Kargo (tn)	1,836	2,096	(11.1%)



Viti 2009 tregoi një zhvillim shumë pozitiv të trafikut si në atë të pasagjerëve ashtu dhe në lëvizjet e trafikut ajror. Rritja me 10,1% në numrin e pasagjerëve shënoi një rekord, duke marrë parasysh periudhën sfiduese të industrisë së aviacionit për shkak të rënies ekonomike të kohëve të fundit. TIA citohet të jetë “Aeroporti me performancën e dytë më të mirë në kontinentin evropian”, nga ana.aero, një faqe web me lajme dhe analiza lidhur me linjat ajrore. Performanca e TIA-s është kaluar vetëm nga Aeroporti i Rigës, me vetëm 0,1% më shumë në rritje të pasagjerëve. Ky vit është karakterizuar kryesisht nga dy periudha piku, një gjatë periudhës së Pashkëve dhe tjetri në verë. Pasagjerët të cilët vizitojnë miqtë dhe të afërmit mbeten forca lëvizëse në trafikun e TIA-s.

TIA ofron 33 destinacione direkte, me katër rrugë të reja drejt Shtutgartit, Liezhit, Napolit dhe Zyrihut, destinacione të përruara në vitin 2009. Përveç kësaj, TIA ofron lidhje shumë të mirë me anë të shërbimeve tranzite me qendër në Romë, Mynih, Vjenë, Stamboll, Lubjanë dhe Budapest.

Trafiku i mallrave, paraqiti një rënie prej 11,1% për vitin 2009 krahasuar me 2008. Kriza ekonomike dhe rënia e volumit të tregtisë në linja të përgjithshme vlerësohen të jenë faktorët kyç për këtë rënie. Turkish Airline përruroi një shërbim të dedikuar mallrash në qershor, duke operuar një herë në javë me fluturimin A310 në TIA.

Zhvillimi i Aeroportit

Në vitin 2009 zhvillimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës vazhdoi sipas projekteve të menaxhimit dhe në përputhje të plotë me Marrëveshjen e Koncesionit me fillimin e zbatimit të Fazës B të projektit, duke rezultuar në përfundimin në kohë dhe hapjen e fazës B të Terminalit të ri të pasagjerëve më 09 shtator 2009. Punimet, përfshinë projektimin dhe ndërtimin e vetë ndërtesës si dhe prokurimin, instalimin dhe testimin e sistemeve të veçanta të aeroportit si dhe prokurime të tjera të ndryshme.

Përfundimi i suksesshëm i obligimeve përkatëse shtesë në bazë të Marrëveshjes së koncesionit është raportuar për Qeverinë Shqiptare nëpërmjet një Çertifikate Përfundimi më 19 gusht 2009, lëshuar nga Inxhinieri i Kualifikuar Obermeyer Beraten+Planen, Mynih, Gjermani.

Paralel me punimet për zgjerimin e terminalit u zhvillua një tjetër projekt madhor, zgjerimi i anës veriore të pistës së aeroportit (rreth 21.000 m²), i cili gjithashtu përfundoi me sukses duke qenë plotësisht operativ në gusht 2009.

Përveç këtyre dy projekte të mëdha, janë trajtuar edhe projektet në vijim, të cilat janë përfunduar nga TIA Construction po në vitin 2009:

- Përmirësimi i pajisjeve në zonën ajrore
- Rikonstruksioni i Zjarrfikësit të Aeroportit
- Rikonstruksion i Portës A
- Blerja e pajisjeve të mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme
- Përmirësimi i pajisjeve për sistemin u uljes së avionëve



Shëndeti, Cilësia dhe Siguria e Mjedisit

Gjatë vitit 2009, TIA vazhdoi të operonte me standardet më të larta të sigurisë, cilësisë dhe në përputhjet me standardet e mjedisit. Politikat e Cilësisë dhe politikat e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës janë zbatuar përmes Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit dhe Cilësisë, përkatësisht në përputhje me Standardet e Cilësisë ISO 9001 dhe të Mjedisit ISO 14001.

TIA ka kryer monitorime të rregullta të aspekteve mjedisore si: (uji, mbetjet urbane, cilësisë së ajrit, nivelet e zhurmave, energjisë, florës dhe faunës) për të kontrolluar zhvillimin kundrejt angazhimeve të përgjithshme politike, në mënyrë që të parandalojë ose zvogëlojë ndikimet mjedisore në afërsi të Aeroportit dhe të identifikojë ku duhet të kryhen veprimet korrigjuese nëse ato janë të nevojshme.

Kjo u konsiderua një çështje shumë e rëndësishme, duke patur parasysh sidomos zgjerimin e aeroportit vitin e kaluar. Në këtë drejtim vëmendje të veçantë iu kushtua si fillim implementimit të një Programi Monitorimi për Mbrojtjen e Mjedisit.

Edhe me rritjen e lëvizjes së trafikut ajror, operimeve të tjera dhe aktivitetit të ndërtimit, rezultatet e matjeve të kryera ishin më shumë se të kënaqshme, brenda standardit limit. Këto rezultate ishin të pritura që nga koha e përgatitjes së raportit paraprak të vlerësimit mjedisor, gjatë fillimit të Fazës B. Masat zbutëse të parashikuara në raport janë zbatuar saktësisht nga firma e ndërtimit për të ndaluar emetimet ndotëse të tepërta në ajër.

Me zgjerimin e terminalit, TIA ka parashikuar të arrijë nivelet më të larta të cilësisë së shërbimit të pasagjerëve, duke bërë të mundur një zhvillim përtej arritjeve të mëparshme. Kjo është bërë e mundur nëpërmjet përmirësimit të nivelit të shërbimit të ofruar dhe përmbushjes së kërkesave të konsumatorëve, sigurimin e përdorimit të pajisjeve bashkëkohore, duke përfshirë shtesa të hapësirave në sportelet e pritjes së pasagjerëve, në portat e daljes dhe duke ofruar një zonë të re për pirjen e duhanit.

TIA vlerëson çështjen e sigurisë operative si një përparësi kryesore, duke siguruar që gjithë personeli të jetë i vetëdijshëm për përfshirjen individuale, rolin dhe përgjegjësitë në rast të një aksidenti të mundshëm pa reflektuar asnjë ndikim mbi mjedisin. Procedurat përkatëse dhe trajnimet kanë ndihmuar për të arritur këtë objektiv. Në prill 2009 TIA testoi me sukses një situatë emergjence. Stërvitja në shkallën e duhur për situata emergjence ka reflektuar në përgjigjen e menjëhershme të stafit të TIA-s kundrejt situatave të tilla.


Performanca dhe standardet e operimit në TIA testohen vazhdimisht për të parë nëse standardet janë përmbushur dhe matje të vazhdueshme kryhen për të testuar reagimet e konsumatorëve dhe nivelin e kënaqësisë së tyre. Përveç kësaj, është bërë i mundur hulumtimi i tregut të gjerë me anë të një "ankete për kënaqësinë e konsumatorit", rezultatet e të cilave tregojnë se cilësia e shërbimeve dhe lehtësirave që ofrohen nga TIA mbeten në përgjithësi "shumë të mira apo të shkëlqyera".

Një përmbledhje e performancës dhe arritjeve të TIA-s është pasqyruar në Buletinin e katërt Mjedisor të botuar nga vetë TIA.

Performanca Financiare

Me më shumë se 20.000 lëvizje të Trafikut Ajror si dhe me rreth 1.400.000 pasagjerë të shërbyer, TIA ka arritur në vitin financiar 2009 një xhiro vjetore prej 29.000.000 euro.

Pasqyrat financiare të TIA-s për vitin kalendarik që u mbyll më 31 dhjetor 2009, janë përgatitur në përputhje me SNRF dhe janë audituar nga një auditor i pavarur i jashtëm. TIA rezultoi në



përputhje me të gjitha standardet financiare gjatë gjithë vitit.

Në bazë të zhvillimeve për vitin 2009 dhe konsolidimin e kompanisë megjithë recesionin global ekonomik, TIA parashikon një zhvillim të qëndrueshëm për vitin 2010.

Datë: 20.07.2010

